

BOTA SOT

INTERVISTA

Dr. Solioz: Kosova duhet t'i japë prioritet përmirësimit të imazhit

Intervistë ekskluzive me dr.Christopher Solioz, sekretar i përgjithshëm i CEIS në Gjenevë

FAQE 08-09



E përditshme kombëtare / Albanian daily www.botasot.info. Viti XV. Numër 5625. (Montag) 1.30€ 2.50 SFR



Kthimi i shpresës së humbur për shqiptaret në Veri!

Jehona e vizitës në Veri! **06**

Antiamerikanizmi çakall në emër të „lirisë së shprehjes“

Nga Elida BUÇPAPAJ - **05**

Kushtetuta nuk është shkelur, as cenuar!

Kush janë shkelësit e vërtetë të Kushtetutës apo lajthitësit? **04-05**



Lunaçek nuk mendon se është shkelur Kushtetuta

Të ndëshkohen komisionarët që mashtruan **03**



AKTUALE

Dhjetë familje skamnore ndajnë pagën e presidentit Pacolli

Presidenti Pacolli vizitoi familjen skamnore Bunjaku **02**

SPORT

Nuhju e kthen në binarë Rapidin e Vjenës

Shqiptari Atdhe Nuhju e ka kthyer në binarë Rapidin e Vjenës. Falë lojës së tij të mirë, Rapid shënoi fitore me rezultat 2:0 në ballafaqim me Kapfenbergun, në ndeshjen e javës së 22-të të elitës së futbollit austriak... **28**



Dituria Reisebüro

airberlin germanwings HAMBURG international

DÜSSELDORF - PRISHTINË
Tel.: 0211-164 64 06

STUTTGART - PRISHTINË
Tel.: 0711-223 70 11

Hannover, Hamburg, Frankfurt, München
Prishtinë, Shkup dhe Tiranë

RISI Dituria edhe në Bielefeld
Tel.: 0521-52154 01

Kënaqësia juaj - qëllimi ynë! www.dituria.de
E-Mail: info@dituria.de

take off with

KOSOVA REISEN

ZÜRICH PRISHTINË 044-215 20 20

Postkonto: 85-72982-3
Fax: 044-215 20 25
Löwenstr. 69 • 8001 Zürich

Kosova Fly REISEBÜRO

Grupello Str. 22 - 40210 Düsseldorf

Fluturime direkte nga: **GJERMANIA**

për në:

- PRISHTINË
- TIRANË
- SHKUP

TELEFONI KUIDESTAR: 0177 - 36 93 097

0211 - 36 77 300

www.kosova-fly.de • info@kosova-fly.de



Debate

Shkruan:
SAIMIR LOLJA

Çregjistrimi i përkatësisë fetare

Një shtet bën regjistrime të popullatës për gjëra konkrete, të prekshme: njeriu vetë, familja, adresa, shtëpia, pasuria, pronësia, punësimi e biznesi. Këtë shteti e bën me qëllimin për të mbledhur taksat, për të planifikuar shërbimet dhe zhvillimet e ardhshme të qytetarëve të tij. Prandaj nuk ka kuptim që shteti të bëjë regjistrim fetar (ideor), sepse kishat apo xhamitë e bëjnë vetë regjistrimin e klientëve të tyre. Ajo që duhet të bëjë shteti për kishat e xhamitë është regjistrimi i pasurive të luajtshme e të paluajtshme të tyre, por për të njëjtin qëllim: tatimin e tyre. Kishat e xhamitë janë pasuri e shtetit shqiptar dhe si të tilla i japin llogari vetëm atij, i cili gjithashtu e ka për detyrë t'i vëzhgojë për t'i mbrojtur edhe se mos bien në grackën e veprimtarive armiqësore kundra shtetërore dhe kundra kombëtare. Besimi fetar nuk ka qenë apo është platformë bashkuese e përfaqësuese për shqiptarët, prandaj çdo vijëzim apo ngjyrim fetar është në dëm të shtetit dhe kombit shqiptar. Për shkak të paditurisë kombëtare, nxitjes nga jashtë si dhe edukimit të urrëjtjes të edukuar nga klerikët fetarë, të cilat sollën luftën midis shqiptarëve të krishterë dhe atyre myslimanë, shqiptarët humbën para rreth 200 vjetëve atë që sot njihet me emrin Greqi. Edhe në rastin e të menduarit më të mështë, më të cekët e më të ngushtë, i cili pranon se "s'ka ndonjë gjë të keqe regjistrimi i përkatësisë fetare", duket se harrohet me dashje ose pa dashje situata e Shqipërisë dhe nga cilët rrethohen shqiptarët. Së pari harrohen grekërit, të cilët janë si zombis (të ngriturit nga varret), të cilët kërkojnë Epirin, një ndarje administrative romake e më shumë se 2000 vjetëve të shkuara. Po ashtu, nga mesi i shekullit XIX, grekërit psallmuan idenë e Greqisë së Madhe (Megalidhea) me qëllim rilindjen e perandorisë fetare bizantine, të tretur në mesin e shekullit XV. Që atëherë, me synimin për një Greqi të Madhe, grekërit kanë kryer luftëra me tërë shtetet për qark, kanë pushtuar toka, kanë kryer masakra të panumërta, përzënie të popullsisë dhe gjenocide. Frymëzimi dhe mjeti i realizimit të Greqisë së Madhe ka qenë e është kisha. Për grekërit, ashtu si edhe për vëllezërit e tyre bizantinë serbë, kisha është shenja e pushtimit të tokës dhe popullatës. Për grekërit, "grek" është kushdo që është i besimit fetar lindor (ortodoks). Së dyti harrohen levantinët shqiptarë (të shpjeguar nga Faik Konica 100 vjet më parë), të cilët shndërrohen shpejt në specien "shitarë" mjafton të jenë ato që s'janë. Së treti harrohen gjasat politike shqiptare që e kanë bërë Shqipërinë zyrtare këto 20+ vjet një vend që i plaçkiten pasuritë natyrore dhe njerëzore, si dhe një shtet të nëpërkëmbur. Në Shqipërinë komuniste njerëzit dënoheshin deri me pushkatim nëse i ngriheshin kurthi i të menduarit ndryshe. Prandaj edhe pyetjet e vrazhda "I cili besim fetar jeni?" apo ato të perëndimuar, "A e praktikon besimin tuaj fetar?" janë të pakuptimta, fyese dhe armiqësore për Shqipërinë e shqiptarët. Tani, në Shqipëri nuk dënohet apo përndiqet njeri prej besimit fetar vetjak. Prandaj, s'ka ndonjë arsye për të regjistruar se sa vetë përndiqen apo dënohen për shkak të ndonjë besimi fetar. Meqenëse tani me Kushtetutë, shteti shqiptar është i ndarë nga feja, atëherë organet themelore të ruajtjes së shtetit shqiptar, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykata Kushtetuese, kanë për detyrë të shpallin të pavlefshme çfarëdo pyetje fetare në formularin qeveritar të regjistrimit të popullsisë. Akoma, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykata Kushtetuese kanë për detyrë të fillojnë ndjekjen ligjore për tërë ato që kanë organizuar, urdhëruar e porositur futjen e pyetjeve fetare në formularin e regjistrimit të popullsisë. Ndonëse do nevojitej kohë me numëruar institucionet e universitetet shtetërore, universitetet personale dhe zyrat e shoqatave jo-qeveritare në Shqipërinë zyrtare, si dhe gazetatat e pavarura (nga Shqipëria), prapëseprapë ato nuk kanë bërë asgjë në lidhje me çështjen në fjalë. Ato nuk bëjnë asgjë kur ishin përpjekjet për të realizuar dhurimin e porositur të detit shqiptar Greqisë. Ato nuk bëjnë asgjë edhe për plehrat evropiane që mund të mbulojnë e tymosin me helme tërë Shqipërinë. Prandaj, është mision i secilit që i thotë vetes shqiptar të ndikojë që pyetjet fetare, edhe ato të "butat", të hiqen nga pyetësori. Nëse "shitarët" dhe mendjecëkët nuk i heqin, atëherë të ndikojë (dhe t'ia thotë kujtdo që njeh) që në përgjigje pyetje të tilla të zhgarraviten (t'iu hiqet viza). Ky mision nuk është për thashethemexhinjtë, nuk është për ato që rrinë ulur galiç tek guri i derës, nuk është për vigjilentët dhe të emëruarit e tufëzave politike shqiptare. Shpirtin e vet e di secili vetë dhe të tjerët s'kanë punë me të. Nëse dikush dëshiron të besojë në ndonjë rrëfim, le të besojë; ajo është çështje vetjake e brendshme dhe ideore, ashtu siç është shpirti i njeriut.

Intervistë ekskluzive me prof.dr. Christopher Solioz, sekretar i përgjithshëm i Qendrës Evropiane për Strategji dhe Integritime (CEIS) në Gjenevë

Dr. Solioz: Kosova duhet t'i japë prioritet përmirësimit të imazhit

"Kosova ka humbur imazhin e vet edhe para daljes publike të raportit të senatorit zviceran Dick Marty. Ky imazh nisi të binte menjëherë pas akuzave të EULEX-it për korrupsion dhe pas tërheqjes nga postet e tyre të Fatmir Sejdiut dhe Hashim Thaçit, që edhe jeta politike disi nisi të paralizohet, duke krijuar krizë të institucionale...", thotë dr. Christophe Solioz, ekspert ndërkombëtar dhe sekretar i përgjithshëm i Qendrës Evropiane për Strategji dhe Integritime në Gjenevë.

Nefail MALIQI

GJENEVË, SHKURT ■ Prof.dr. Christophe Solioz, sekretar i përgjithshëm i Qendrës Evropiane për Strategji dhe Integritime (CEIS) në Gjenevë është njëherësh ekspert për çështje ballkanike sidomos në procesin e tranzicionit në Bosnjë, Serbi, Kroaci e Kosovë. Profesor Solioz është bashkautorë i disa librave dhe një sërë shkrimesh me ambasadorin austriak Wolfgang Petritsch. Për situatën aktuale në Kosovë dhe vendet fqinje, për raportin e Dick Martit për Kosovën si dhe shqiptarët e Luginës së Preshevës ishin disa pika që prekëm në intervistën ekskluzive për gazetën « Bota sot ».

Serbia do ta njohë pavarësinë e Kosovës

"Bota sot": Z.Solioz janë bërë dhjetë vjet e 15 vjet për dikë nga lufta në Ballkan, ku nga një ish-republikë e madhe ta quajmë kështu «Jugosllavinë» e Titos u bënë për pak vite 7 republika të vogla, shtete këto të reja , përfshirë këtu edhe Kosovën, ku secila pavarësi u pagua me gjak e viktima. Ju si eksperte ndërkombëtar si e vlerësoni sot zhvillimet në rajon?

Dr. Christophe Solioz: Situata e pasluftës padyshim

është shumë më e mirë. Por, megjithatë në rajon ka mbetur edhe shumë për t'u bërë. Për të folur për një situatë vërtetë stabile. Si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, Maqedoni, Bosnje fatkeqësisht ende kemi një situatë të brishtë. Vërtetë kërcënimet e luftës janë tejkaluar po kriza institucionale në Serbi, Maqedoni, në një shkallë më të vogël në Shqipëri, janë vende të cilat shqetësojnë jo vetëm popullatën e rajoneve, por edhe bashkësinë ndërkombëtare. Sot ndër problemet më shqetësuese për komunitetin ndërkombëtar janë korrupsioni dhe krimi i organizuar, që ka përfshirë rajonin si në Kosovë ashtu edhe në Serbi e më gjerë... Ne jemi të shqetësuar gjithashtu se proceset në rajon po zhvillohen me një dinamizëm me shpejtësi të ndryshme, të cilat do të ndajë më tej Ballkanin. Për shembull Kroacia dhe Serbia do të bashkohen me vendet e tjera të Ballkanit drejt anëtarësimit në familjen e madhe të BE-së sikur Sllovenia dhe Greqia, ndërsa të tjerët do të vijin më vonë si Shqipëria, Bosnja, Maqedonia dhe Kosova... Ballkani mund të luajë rol të jashtëzakonshëm për paqen dhe stabilitetin në rajon. Sikur Serbia që nuk mund të bashkëpunojë vetëm me Rusinë apo vendet sllave po ashtu as Kosova nuk

mund të bashkëpunojë vetëm me Shqipërinë, por bashkëpunimi duhet edhe me vendet tjera si me Serbinë, me Maqedoninë, Malin e Zi... ky bashkëpunim do të jetë kontribut i fëmijësisë së mirë dhe perspektivës më të sigurt drejt integritimeve evropiane

"Bota sot": Siç e dinie sivjet sikur ne Kosovë edhe këtu në Perëndim, përfshirë këtu edhe Zvicrën, shqiptarët kanë kremtuar trevjetorin e pavarësisë. Mendoni se në këto tri vjetët e fundit Kosova ka bërë progres?

Dr. Christophe Solioz: Po, mund të themi se janë bërë gjëra të mira në Kosovë. Por aq sa janë bërë po aq edhe nuk janë bërë përparime dhe Kosova fatkeqësisht ende vazhdon të mbetet vrime e zezë në Ballkan. Mund të them se ka ende shumë për t'u bërë, sidomos në Kosovë pa marrë parasysh raportin e Dick Martit, kjo është diçka çështje në vete. Pavarësia e Kosovës ka mbushur tre vjet





Prof. dr. Christophe Solioz, sekretar i përgjithshëm i Qendrës Evropiane për Strategji dhe Integritet (CEIS) në Gjenevë

dhe sikur një fëmijë trevjeçar që ka probleme të ecë mirë dhe sigurt, ngjashëm ka probleme edhe Kosova në këtë drejtim dhe ende çalon në disa drejtime si në papunësinë e madhe në rajon, më të madhen në Evropën Juglindore, pastaj mungesa e investitorëve të huaj, mostoleranca zero ndaj krimet të organizuar sidomos ndaj korrupsionit që siç e dini edhe pjesëtarë nga kabineti i Thaçit janë në shënjestër të policisë së EULEX-it dhe ndërkombëtareve për korrupsion. Dhe të gjitha këto së bashku, hiq raportin e Dick Martit, kanë bërë që Kosova ta humbë imazhin e vet muajve të fundit, sidomos nga paralizimi i institucioneve me rastin e tërheqjes nga postet e tyre të Fatmir Sejdiut dhe Hashim Thaçit. Dhe kjo ka bërë që Kosova ka ngecur në 75 njohje pas tri vitesh të shpalljes së pavarësisë. Dhe tash nevojitet kohë e gjatë që Kosova të drejtohet, sepse autoritetet e Prishtinës, të qeverisë së re, nuk mund

të flasin për lobim apo integritet, përderisa nuk i rikthejnë imazhin Kosovës. Kosova nuk do të ketë reputacion të mirë përderisa nga rajoni dhe institucionet nuk largohet korrupsioni në rend të parë, dukuri e cila mund të jenë nesër kancer për vendin, pastaj lufta kundër kriminit të organizuar, hapja e vendeve të reja të punës dhe zbutja e papunësisë etj...

“Bota sot” : Z.Solioz i kthehem Raportit të Dick Martit. Raporti doli ashtu siç u miratua rezoluta rreth tij në Strasburg. U shkrua e u tha shumë në gazeta e medie rreth raportit duke mos munguar as akuza të ndërsjella. SHBA-të sikur edhe Tirana dhe Prishtina bashkë me EULEX-in thonë OK, urdhëroni bëni hetime, por na sillni edhe fakte, dëshmi...Me një fjalë ku e ka fundin ky raport dhe a mendoni se ka zbehur imazhin e Kosovës duke mos kontestuar pavarësinë, siç na kishte deklaruar presidentja e Zvicrës znj.Calmy-Rey?

Dr.Christophe Solioz: Asnjë vend nuk mund t'i shpëtojë historisë së saj, të kaluarës së saj, sikur as Zvicra, as Franca, as Shtetet e Bashkuara... e as Kosova. Më asgjë nuk mund të justifikojë krimet e luftës, pastaj nuk ka falje në këtë fushë. Në një situatë të tillë, ne duhet të tregojnë kurajo të jashtëzakonshme politike. Kosova sot ka nevojë për një njeri, politikan që di të parandalojë korrupsionin dhe t'i thotë stop kësaj dukurie në shoqërinë kosovare, sepse sot 73% e shqiptarëve të Kosovës besojnë se që nga viti 2007 niveli i korrupsionit është rritur në rajon. Siç e dini në çdo luftë ka agresorë dhe viktime apo të sulmuar dhe të mbrojtur..por edhe lufta i ka rregullat e veta, respekti i konventave dhe ligjeve ndërkombëtare edhe pse me arsye mbrohet një çështje. Madje disa politikanë e liderë në Kosovë për këtë regres apo imazh të keq të Kosovës i hedhin fajin Dick Martit. Mos harroni se emri i Dick Marty në çështjen e Kosovës është i ri që njihet vetëm nga rezoluta e Strasburgut qe 3-4 javë, dhe këto ngecje diplomatike apo kriza politike sikur edhe korrupsioni datojnë më herët, me muaj e vite të tëra më parë, para janarit të këtij viti, para rezolutës së Asamblesë së Këshillit Evropian të raportit të Dick Martit.

Asnjëherë unë nuk i kam konsideruar si tradhtarë të Kosovës miqtë e mi nga Kosova, të cilët i njoh kaherë të cilët ishin të angazhuar bashkë me mua për dialog dhe bashkëpunim me Beogradin. Edhe unë jam për pavarësinë e Kosovës por jo kështu, jo me disa njerëz në qeveri çka jorastësisht është kërkuar një qeveri më serioze dhe me duar të pastra. Thaçi e ka ditë mirë edhe para dy vitesh se ky raport herdokur do të dalin në shesh, pastaj zgjedhjet u kryen ku nuk ishin të vogla kritikë e vëzhguesve ndërkombëtar për parregullsi...Dhe mos harroni se Dick Marti nuk është prokuror, por thjesht ai është politikan i cili tashmë së fundi, është ngarkuar nga KE për të përgatitur një raport mbi trafikun e organeve gjatë luftës në Kosovë, të cilat indikacione theksohen edhe në librin e fundit të ish-kryeprokurorës së TPI-së Carla del Ponte. Dhe EULEX-i nuk është as sot një gjende të tillë ta bëjë, por do të ishte mirë themelimi i një tribunali special, ad hoc që do të autorizohet nga OKB apo BE për të ndriçuar këtë aferë, akuzat që janë në raportin e Martyt. Hapi i parë do të ishte siguria e dëshmitarëve, që ish-Tribunali nuk kishte sukses në disa raste. Dhe kërcimit e Thaçit ndaj atyre që kanë shprehur vullnet dhe gatishmëri të

Dinamizmi

■ Ne jemi të shqetësuar gjithashtu se proceset në rajon po zhvillohen me një dinamizëm me shpejtësi të ndryshme, të cilat do të ndajë më tej Ballkanin. Për shembull Kroacia dhe Serbia do të bashkohen me vendet e tjera të Ballkanit drejt anëtarësimit në familjen e madhe të BE-së sikur Sllovenia dhe Greqia, ndërsa të tjerët do të vijin më vonë si Shqipëria, Bosnja, Maqedonia dhe Kosova.

Perspektiva

■ Siç e dini struktura etnike në Serbi është e përzier, që në të jetojnë pos shqiptarëve etnikë nga Lugina e Preshevës edhe të tjerë si ata në Vojvodinë, Sanxhak e pakica të tjera. Politika e BE-së është e qartë si për Serbinë, ashtu edhe për Kosovën dhe vendet tjera në Ballkan se nuk ka integritet dhe perspektive të mirë me diskriminim të pakicave. Mos harroni se Ballkani është ndërtuar me popuj të përzier me histori të larmishme, ku secili ka historinë e vet.

bashkëpunojnë me gjykatat ndërkombëtare, nuk janë shenja të mira.

Kosova, Serbia bashkë me Preshevën perspektivën e kanë ën BE

“Bota sot”: Në një koment të titulluar **“Serbia nuk është Kosovë”, kemi lexuar e dëgjuar që Kosova s’është Serbi, por jo ashtu siç e keni titulluar një analizë, koment tuajin për zhvillimet në rajon. Çka keni dashur të thoni me atë se « Serbia nuk është Kosovë » ?**

Dr.Christophe Solioz: Serbia e Zoran Gjingjiqit nuk është ajo Serbia e Millosheviqit, apo Serbia e Tadiqit nuk është ajo Serbia e Koshtunicës. Mund të themi se Gjingjiq mund të konsiderohej si De Goli i Francës, por nuk di se a mund të thuhet për Tadiçin ngjashëm apo ajo. Pastaj politikani tjetër Goran Svilanoviçi nga Kosova i cili kishte një karrierë të pasur politike, madje me përcaktime pro pavarësisë së Kosovës, jep një çikë shpresë se në Serbi pas rënies së regjimit të Millosheviqi mund të kenë njerëz, personalitete që janë në favor të dialogut dhe marrëveshjeve, bashkëpunimit me vendet rajonale.

Me këtë desha të them se në Serbi nuk janë të gjithë kundër pavarësisë së Kosovës dhe nëse sot jo, nesër sigurisht po, Serbia do ta njoh shtetit e Kosovës. Për mua pavarësia e Kosovës, e legjitimuar tashmë edhe nga Gjykata Ndërkombëtare, aktualisht është teorike dhe ende jokualitative, i cili proces do të zgjasë ende sepse ka edhe shumëçka për t'u drejtuar në rajon.

“Bota sot”: Derisa mbrohet Dick Marti pas imunitetit, tash edhe Thaçi ka imunitetin e vet si kryeministër. Pra, që të dy nën imunitet dhe akuza ndaj njëri-tje-

trit. Komenti juaj z.Solioz?

Dr.Christophe Solioz: Nuk di sa qëndron ky krahasim, por mund të themi një gjë se Dick Marti përderisa ka duar të pastra nuk di sesa do t'i ndihmonte atij imuniteti. Pati, s'pati ky i fundit imunitet, procesi i hetimeve do të vazhdojë ashtu-kështu. Thaçit nuk i bien të luajë me imunitetin. Nuk ka implikim të shkallës së parë, ai ka qenë sigurish në dijeni rreth ndonjë ngjarje për çka akuzohet në raport. Sepse raporti i Martyt nuk e akuzon atë drejtpërdrejt. Thaçi në ato kohë ka pasur funksione më të larta në UÇK, qoftë ato politike apo ushtarake.

“Bota sot”: Shumë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë kur flasin për pakicën serbe në Kosovë nuk lënë pa përmendur edhe shqiptarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes. Mendoni se pakica serbe sot është e privilegjuar në Kosovë dhe se duhet zgjidhje reciproke të statusit të tyre me shqiptarët e Luginës së Preshevës?

Dr.Christophe Solioz: Siç e dini struktura etnike në Serbi është e përzier, që në të jetojnë pos shqiptarëve etnikë nga Lugina e Preshevës edhe të tjerë si ata në Vojvodinë, Sanxhak e pakica të tjera. Politika e BE-së është e qartë si për Serbinë, ashtu edhe për Kosovën dhe vendet tjera në Ballkan se nuk ka integritet dhe perspektive të mirë me diskriminim të pakicave. Mos harroni se Ballkani është ndërtuar me popuj të përzier me histori të larmishme, ku secili ka historinë e vet dhe interpretohen në mënyra të veta, madje edhe me kërkesa për shtete të madha, si « Serbia e madhe » apo « Shqipëria e madhe »...por këto kërkesa kanë mbetur vetëm terma dhe forcat e reja politike në rajon kanë kuptuar se realiteti dhe perspektiva e tyre do të jetë vetëm të bashkuar në Evropën e madhe, dikush sot e dikush më vonë. ■